

## AKT-THEMELIMI I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### “HERMES 2024” SH.P.K.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve themelues të shoqërise me përgjegjësi të kufizuar “HERMES 2024” Sh.P.K dhe me emër tregtarë “HERMES 2024” Sh.P.K. themelohet nga ortakët :

1. **Giorgio D'Ambrosio**, atësia **Antonio**, amësia **Giuseppina**, shtetas Italian, lindur me **04.03.1986** në **Pollena Trocchia, Napoli, Itali**, rezident në Itali dhe banues në adresën : **Roma**, Via Fedrico Nansen 56, Scala A, int 16, 00154 madhor me zotësi të plotë juridike, për të vepruar, i identifikuar me anë të dokumentit pasaportë me numër **YC1074019**.
2. **Suida Arçi**, atësia **Xhemil**, amësia **Djana**, shtetase shqipëtare, lindur me **17.08.1987** në **Shkodër**, rezidente në Itali dhe banues në adresën : **Roma**, Via fedrico Nansen 56, Scala A, int 16, 00154, madhor me zotësi të plotë juridike, për të vepruar, e identifikuar me anë të letërnjoftimit me numër **036902821** dhe numër personal **I75817115D**.

Në përputhje me vullnetin e lirë dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit Shqipëtar, vendoset të hartohet ky akt - themelimi i shoqërise “HERMES 2024” Sh.P.K. mbi bazën e këtyre principeve :

#### NENI 1

##### FORMA DHE EMRI

Shoqëria ka formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, me initiale SH.P.K, dhe i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar.

Emri i shoqërisë do të jetë “HERMES 2024” Sh.P.K.

#### NENI 2

##### BAZA LIGJORE

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007, i ndryshuar “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ,Ligji me Nr.9901, date 14.04.2008, I ndryshuar “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “,në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombetare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

#### NENI 3

##### SELIA





Selia e Shoqërise **“HERMES 2024” Sh.P.K.** është në adresën: **Shqipëri, Shkodër, Rruga Hafiz Sabri Bushati, Godine 5-katëshe, kati I, Nr. 1**

Në adresën e mësipërme do të identifikohet Selia Qëndrore e Përsoneit Juridik **“HERMES 2024” Sh.P.K.**

Me vendim të asamblesë së Ortakëve, mund të hapen degë, filiale, agjensi ose përfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat ushtron veprimtarinë shoqëria.

#### **NENI 4**

#### **KOHËZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQËRISË**

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa - caktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent.

Shoqëria priset dhe kalon në procedurë likuidimi, sipas rasteve të parashikuar në ligj.

#### **NENI 5**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Shoqëria **“HERMES 2024” Sh.P.K.**, është e organizuar në formën e saj juridike si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila ka si objekt të aktivitetit :

Kurse online, organizim i seminareve, workshop dhe azhornim të programeve të dedikuara për individë dhe kompani, në fushën financiare, ekonomike, të biznesit dhe teknologjisë. Organizim i kurseve, seminareve dhe aktiviteteve të formimit në fushën e financës, tregtimit, investimeve dhe menaxhimit të rrezikut, qoftë në prani fizike apo online. Konsulencë nëpërmjet mjeteve elektronike dhe informatike, të produkteve jo ushqimore, duke përfshirë software, faqe interneti dhe platforma online. Menaxhimi i portaleve e-commerce, faqeve të internetit dhe platformave të rrjeteve sociale dhe të tjera me qëllime tregtare dhe informuese. Aktivitete mbështetëse për ato të përmendura më lart, duke përfshirë realizimin dhe shitjen e botimeve editoriale (si në formë të shtypur ashtu edhe digjitale), prodhimin e përmbajtjeve audiovizuale, si dhe zhvillimin e software dhe mjeteve digjitale të dedikuara për tregtimin dhe financën. Aktivitet kërkimore dhe zhvillimi në fushën teknologjike-financiare për zbatimin e algoritmeve dhe zgjidhjeve inovative të aplikueshme në tregjet financiare dhe menaxhimin e rrezikut për individë dhe kompani. Shoqëria ka për objekt investimin dhe administrimin e pasurisë së saj, nëpërmjet blerjes, shitjes, mbajtjes dhe menaxhimit të instrumenteve financiare, pjesëmarrjeve shoqërore, pasurive të paluajtshme dhe aktiviteteve të tjera me natyrë pasurore. Përfshihet çdo veprimtari e rezervuar sipas legjislacionit në fuqi, në veçanti mbledhja e kursimeve nga publiku dhe administrimi i pasurisë për llogari të palëve të treta.



## NENI 6

### KAPITALI THEMELTARË

Kapitali themeltarë i Shoqërisë “**HERMES 2024**” Sh.P.K. është 1,000,000 leke (një milion lekë), i ndarë në 2 (dy) kuota ( pjesë ) .

Kapitali themeltar i shoqërisë zotërohet nga:

- 1- **Giorgio D’Ambrosio me 90% të kuotave me vlerë 900,000 LEKË**
- 2- **Suida Arçi me 10% të kuotave me vlerë 100,000 LEKË**

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyhet tërësisht dhe depozitohet në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dytë.

## NENI 7

### AKTET E SHOQËRISË

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akt-themelimi dhe me norma të përcaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person Juridik në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8

### ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe Administratori. Shoqëria mund të emërojë me shumë se një administrator.

Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e Shoqërisë “**HERMES 2024**” Sh.P.K , ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numër.

Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese. Në aktet e krijimit të ketyre organeve do të përcaktohen kohëzgjatja dhe kompetencat e tyre. Administratori i shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjecare është **Z. Arlind Kraja** e identifikuar me numër personal **I20705115R**.

## NENI 9

Suida Arçi



## DISPOZITA E FUNDIT

Çdo mos-marrëveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do ta zgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet, kompetente për gjykimin e mos - marrëveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër .

Ky akt themelim është hartuar në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe duke patur secila kopje fuqi të njëjtë ligjore.

## ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË “HERMES 2024” Sh.P.K

Z. Giorgio D'Ambrosio



Znj. Suida Arçi

